



Të gjitha informata shtesë për të drejtat e juaja dhe mënyrën si të mbroheni nga dhuna në familje mund t'i merrni në këta **SOS telefona:**

 • 070 141 700
• 075 141 700
• 077 141 700



Ky informim u punua në suaza të projektit "Me përpjekje të përbashkëta – Drejt standardeve të reja evropiane për mbrojtjen e grave nga dhuna e bazuar në gjini" (Potpisuvam.org) të cilin e realizojnë Qendra femërore (Serbi), Këshilli nacional për barazi gjinore (Maqedoni) Qendra për gra viktime të luftës (Kroaci), Fondacioni gratë e bashkuara (Bosnja dhe Hercegovina), Shoqata SOS telefon (Slloveni), dhe Rrjeti evropian i femrave kundër dhunës (Austri) në bashkëpunim me Lobin evropian të grave.

Në Maqedoni ky projekt u realizua në bashkëpunim me organizatat lokale si Komiteti i Helsinkut për të drejtat e njeriut dhe LGBTI qendra për mbështetje, Rrjeti nacional kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, Organizata e grave „Vizion“ nga Kavadarci, Organizata e grave në Pehçevë dhe Shoqata për mundësi të barabarta „Ezerka“ nga Struga.



Informata është përgaditur me mbështetjen e Unionit Evropian.

Përmbajtja e informatës është përgjegjësi e autorëve dhe në asnjë mënyrë tjetër nuk i reflekton qëndrimet e Unionit Evropian.



Kompetencat e Policisë në raste të dhunës në familje

Dhunë në familje është kur një ose më shumë anëtarë të familjes ju kërcenohen ose ju lëndojnë:

- Ju shtyjnë, ose ju godasin me shuplakë, ju rrahin, ose në çfarëdo mënyrë tjetër ju lëndojnë;
- Ju maltreton, ju nënçmon, ju lëndon ose të drejtohet me fjalë ofenduese;
- Nuk ju lejon të lëvizni lirshëm ose ua ndalon kontaktet me anëtarët e familjes dhe miqtë;
- Nuk ju lejon të punoni dhe të fitoni, ose paratë që i keni fituar ua merr, ose ju detyron të punoni punë të cilat ju nuk i doni;
- Nuk ju jep dihmë dhe nuk ju mbron juve dhe anëtarët tjerë të familjes;

Institucionet e para nga të cilat mund të kërkoni ndihmë dhe mbrojtje janë: Qendra për punë sociale dhe Policia.

Kompetencat e policisë në raste të dhunës janë që ta mbrojnë personin – viktimën, të bëjë bulimin e atij që e ka kryer veprën dhe të ndalojë dhunën në familje:

- Biseda duhet të bëhet ndaras, me atë që ka kryer veprën e dhunës, dhe viktimën.
- Policia pasi merr të dhënat e dhunesit ata duhet të vërtetojnë se a ka nevojë për ndihmë medicinale.
- Nëpunësi policor duhet të jetë i kujdesshëm dhe deri në fund ta dëgjojë kronologjinë e ngjarjes dhe të tregojë kuptim për gjendjen në të cilën është viktimia.
- Viktimës duhet thënë se nuk është fajtorë / fajtor për incidentin.
- Bisedë ndaras bëhet edhe me dhunuesin dhe duhet të vërtetohet se atij ose asaj i nevojitet ndihmë mjeksore.
- Për masat e ndërmarra menjëherë ose më së voni pas 48 orëve nëpunësi policor duhet me shkrim të njoftojë Qendrën për punë sociale.
- Nëse ka elemente për përgjegjësi penale ata kanë për detyrë të parashtrajnë padi penale kundër kryerësit të veprës.

Nëse policia nuk ka vepruar sipas dispozitave ligjore mundeni:

- T'i drejtoheni në formë të shkruar komisionit për kontrollë të brendshme;
- T'i drejtoheni me shkrim Ministrisë për punë të brendshme;
- T'i drejtoheni për ndihmë organizatave joqeveritare, veçanërisht atyre të cilat mundësojnë ndihmë juridike gratis;
- Me aktpadi të kërkoni mbrojtjen e drejtave të juaja.

